

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

BJH-1

245

VANGJEL  
LEKA

poezi

JEHONA  
E  
BRIGJEVE


814-1  
245



VANGJEL  
LEKA

JEHONA  
E  
BRIGJEVE

poezi



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



VANGJEL  
LEKA

LEHONA  
E  
BRIGJEVE

poezi

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re

Tiranë, 1978

## VJELËSET E AGRUMEVE

Flokët i lidhin vajzat fshatare,  
shportat i varin degë më degë,  
këpusin kokrrat sytsorkadhet,  
ballin si hënë, faqet si shegë.

Kokërr më kokërr, pa i gërvishtur,  
i mbajnë në duar, i vënë në shportë,  
sepse me djersë i kanë rritur,  
u dhanë frymë në zheg a shqotë.

Në dorën e tyre këndojnë gërshërët,  
kokrrat e fryra i vënë në shporta.  
Nxitojnë duart, s'dallohen llërët,  
e çfarë nuk bëjnë këto motra.

Nga dora shatin nuk e ndajnë,  
nga librat nuk i heqin sytë,  
në festivale vallen mbajnë  
ushtojnë këngët për Partinë.

Dhe kur në fshat të deh aroma,  
nga portokallet, sfaka e xina,  
vajzat ngrejnë shportat me limona,  
mandilebardhat, syvetëtima.

## MAJË MALIT TË ÇIKËS

Majë Çikës u ula dhe këmbët m'u varën në det,  
gadishull malesh gëlqerorë, kuarcite të bardha, të  
zhveshura,  
majë tyre syri i diellit, poshtë deti i paanë.  
Hordhitë barbare gjatë shekujve u përplasën nër  
këta shkëmbinj,  
na dogjën shtëpitë, plaçkitën e vranë,  
por që të gjithë nër honet e thepisura ranë,  
ndërsa qielli ynë mbeti gjithmonë  
plot dritë dhe i qeshur.

## Y J E

Gjithmonë deshëm të kishim një yll,  
ta qepnim në kapele,  
ta ngjitnim në bluzë,  
ta puthnim me buzë.

Dhe nënat na bënin yje prej cohe.  
Kur vinte pranvera e lulëzonte shega  
pipthat e tyre si yje të kuqe  
i këputnim nga dega  
ku digjeshin shpuzë.  
O, ishin yjet e pranverës,  
i futnim nër flokë, i ngjitnim nër kopsa,  
i mbanim në buzë!

## U L L I N J T Ë

Përmbi shkëmbinj degët thellë përulen,  
në gjuhë të tyre ç'thonë, nuk e di,  
kujtimet janë rrënjë që nuk shkulen,  
kujtimet janë rrënjë në thellësi.  
Ullishta! Çfarë kujtoni ditë e natë  
dhe sado pak të fryjë e egra shqotë?  
Ju keni paqë haraçë përmbi shpate  
të burrave luftëtarë, kockëfortë.

Në trupin tuaj ju keni mbajtur  
martirë të lirisë me litar në fyt,  
krimbi i mërzisë kurrë s'ju ka brejtur,  
qëndresa veç ju rrit.

Stuhitë e vitet dot s'ju kërrusën,  
me rrënjë zhbiruat nër shkëmbinj të e nxehtë.  
Kudo lulëzoni, tani që shqotat fryjnë më fortë,  
besnike të vendit të vet.

## PEIZAZH NGA DHËRMIU

Ra një lis i hollë tej  
gjithë ullinjtë fëshfërijnë,  
ç'zëra jete që dot s'i gjej,  
shpirtin krejt ma përtërijnë.

Kthehen vajzat e nxitojnë  
mbuluar nga gjelbërimi,  
brigjet tejpertej jehojnë,  
digjet flakë perëndimi.

Nga kodrinat zbresin tufa  
si kope të bardha resh,  
nër tarraca, nëpër gufa,  
zëri i mbrëmjes zbret e qesh.

Dhe një këngë sa vjen e rritet,  
gjithë brigjet i pushton,  
tis i mbrëmjes zgjatet, shtrihet,  
përmbi pemët që rëndojnë.



Mbi çdo plis e gjeth e trung,  
në sofat e prag lëshon,  
o, një gaz të pafund  
përmbi fshatin që lulëzon.

## Y L B E R I

Çobani me bërruc pas dhive fërshëllente,  
guaca kërmijsh piklonin me vesë.  
Ylberi në dy brigje i varur po binte  
në fund të nomesë.

Një botë e tërë në kreshta lëvizte,  
avullonte gjeth i sfakës, këpurdhat pikonin,  
dhe tufa e dhive në kor blegërinte  
dhe retë jargavan në qiell shtegtonin.

Çobani vështroi në ciflat e gurit  
fytyrën e tij nën dritë të ylberit.  
Pika të arta si kokrrat e grurit  
kullonin qimet e bërrucit nën rrezet e diellit.